

Akademia e Drejtësisë
Akademija Pravde
Academy of Justice

Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
 - * Aktivitetet Tjera

Mars 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Kompetencat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

Më 01 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Kompetencat e Dhomës së Posaçme Gjykatës Supreme”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive në zbatimin e dispozitave konkrete të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si edhe të dispozitave tjera që i referohen korrelacionit të juridiksionit të Gjykatës Supreme dhe rrjedhimisht të Dhomës së Posaçme si dhe Panelit të Apelit ndaj Vendimeve të Agjencisë Kosovare të Pronave sa i përket ankesës dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Në kuadër të këtij sesioni trajnues u trajtuan temat në lidhje me juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme, llojet e kompetencës, me fokus në Dhomën e Posaçme, parashtruesit dhe palët kundërshtare në Dhomën e Posaçme.

Në veçanti u trajtua dispozita e nenit 10 par. 1

të Ligjit Nr.03/L-79, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave pronësore të pronës së paluajtshme private duke përfshirë edhe atë bujqësore dhe komerciale që i referohet njoftimit dhe publikimit të parashtrueseve të kërkesave për konstatimin dhe kthimin në posedim të pronave të paluajtshme të pretenduara.

Gjatë këtij trajnimi nga trajnuesit u aplikuan metoda interaktive duke bërë interpretimin e normës juridike, duke paraqitur raste konkrete nga praktika juridike dhe duke i zbërthyer të gjitha paqartësitë dhe dilemat të lidhura me këtë temë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional nga niveli themelor dhe ai i Apelit.



Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve

Më 03 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me veprimet që duhet ndërmarrë për t'i kualifikuar këto vepra penale, si dhe dënimet që shqiptohen për këto vepra, pasi që viktimat janë fëmijët.

Në këtë trajnim gjithanshëm u trajtuan veprat penale kundër integriteti seksual sipas Kodit Penal, sulmi seksual te fëmijët, elementet dhe karakteristikat e veprave penale kundër integritetit seksual të fëmijëve, fëmijët si viktimë e krimit dhe kategori më e ndjeshme e shoqërisë për të cilët shteti me mekanizmat e tij është i obliguar të kujdeset dhe të ju ofroj mbrojtje.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në kuadër të kapitullit veprat penale kundër integritetit seksual ndër të tjera parasheh edhe disa vepra që prekin integritetin seksual të fëmijëve. Njëkohësisht, zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga ky kapitull shpeshherë paraqitet si sfida për gjyqtarët dhe prokurorët. Andaj, trajtimi i këtyre çështjeve u realizua përmes diskutimeve me pjesëmarrësit, për t'u përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe dilemave që mund të paraqiten në praktikën gjyqësore.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



“Bashkë-ndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë”

Më 08 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Bashkë-ndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë”.

Ky trajnim kishte për qëllim që gjyqtarët e fushës civile t'i avancojnë njohuritë e tyre për bashkë-ndërgjyqësinë si institut juridik, i cili në praktikë paraqitet në mënyrë mjaft komplekse, si dhe njëkohësisht të thellojnë njohuritë rreth ndërhyrësve kur ata paraqiten në procedurë, në funksion të zbatimit të drejtë të procedurës dhe vendosjes në mënyrë meritore.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtua nocioni i bashkë-ndërgjyqësisë, llojet e bashkë-ndërgjyqësisë, efektet e vendimeve të bashkë-ndërgjyqësve në procedurën kontestimore, pozita procedurale e bashkë-ndërgjyqësve dhe veprimet e tyre, si dhe pasojat të cilat i shkaktojnë ato veprime.

Më tutje u trajtua pjesëmarrja e personave të

tretë në kontest civil (ndërhyrësit), mënyrat e ndërhyrjes dhe llojet e ndërhyrësve, efekti i aktgjykimit ndaj bashkë-ndërgjyqësve dhe ndaj ndërhyrësve. Gjithashtu u trajtuan edhe llojet e ndërhyrësve, kushtet që parasheh LPK për lejimin e ndërhyrjes si dhe dallimi mes ndërhyrësve.

Në kuadër të kësaj, gjithanshëm u trajtua edhe efekti i aktgjykimit ndaj bashkë-ndërgjyqësve dhe ndërhyrësve në procedurën kontestimore.

Gjatë trajnimit u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit ishin aktiv duke marrë pjesë në diskutime me prezantuesin pas çdo shpjegimi.

Përfitues ishin gjyqtarët e divizioneve civile në gjykatat themelore dhe të Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Trafikimi me Qenie Njerëzore

Më 09-10 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën e Amerikane, në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin dy ditore me temë “Trafikimi me Qenie Njerëzore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me legjislacionin vendor dhe kornizën ligjore ndërkombëtare në luftën kundër veprave penale të trafikimit me njerëz, në kontekst të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.



Në fokus të këtij trajnimi ishte analizimi i hollësishëm i legjislacionit vendor dhe akteve ndërkombëtare që sanksionojnë dhe rregullojnë aspekte të ndryshme që ndërlidhen me elementet, format, procedurat e hetimit,

trajtimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore si dhe format për bashkëpunim efikas kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Në veçanti u trajtua Raporti i Trafikimit me Qenie Njerëzore (TIP), si mjeti kryesor diplomatik i Qeverisë së SHBA për të angazhuar qeveritë e huaja mbi Trafikimin me Qenie Njerëzore.

Në kuadër të këtij sesioni trajnues u zhvilluan diskutime për raste konkrete nga praktika rreth formave efikase se si të identifikohen dhe intervistohen fëmijët që mund të jenë viktime të lypjes së detyruar dhe trafikimin duke shfrytëzuar praktikatat më të mira të SHBA-ve, cilat janë procedurat standarde të veprimit, Strategjia Nacionale për Luftimin e TQNJ, Roli i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave si dhe dëmshpërblimi dhe kompensimi i viktimave të krimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë ligjorë dhe mbrojtës të viktimave.

Zbatimi i së Drejtës Evropiane nga ana e Gjykatave të Republikës së Kosovës

Më 10 mars 2017, Akademia e Drejtësisë, me mbështetje të UNDP, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme realizoi trajnimin me temë “Zbatimi i së Drejtës Evropiane nga ana e Gjykatave të Republikës së Kosovës”.

Ky trajnim kishte për synim të kontribuoj në avancimin e shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'i identifikuar problemet, parregullsitë dhe implikimet në kuadër të këtij aktiviteti si ndikimi i së Drejtës Evropiane në gjyqësorin e Republikës së Kosovës dhe të thellojnë njohuritë rreth mekanizmave dhe Direktivave të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian.

Në fokus të këtij trajnimi ishte analizimi i hollësishëm i parimeve të së Drejtës së Bashkimit Evropian nga gjykatat vendore, epërsia, efekti i drejtpërdrejt dhe tërthortë i BE-së, efekti i tërthortë i Marrëveshjes për Stabilizim Asocim (MSA), dhe efektet juridike

të vendimeve të GJEDNJ në procedurën paraprake.

Po ashtu në sesionin e dytë të mesditës u shtjellua ndikimi i së drejtës së BE-së në gjyqësorin e Kosovës, pozita juridike e së Drejtës së Bashkimit Evropian në Kosovë, pozita e marrëveshjeve ndërkombëtare, raporti në mes Kushtetutës së Kosovës dhe të Drejtës së BE-së, Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian, sundimi i ligjit dhe gjyqësia e pavarur.

Në kuadër të këtij trajnimi u zhvilluan diskutime për raste konkrete nga praktika rreth formave efikase dhe procedurave të së drejtës së Bashkimit Evropian, po ashtu pjesëmarrësit elaboruan raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorët të nivelit themelore.



Parashkrimi

Më 13 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “ Parashkrimi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me llogaritjen e parashkrimit dhe infrastrukturën ligjore për respektimin e tij në praktikë, si dhe për format apo veprimet që duhet ndërmarrë për zbatimin konsekuent në praktikë të dispozitave ligjore që rregullojnë çështjen e parashkrimit.

Gjatë trajnimit u trajtua parashkrimi si institut juridik që nënkupton pamundësinë e ndjekjes penale, shqiptimit të dënimit dhe ekzekutimin e sanksioneve penale apo masave të trajtimit të detyrueshëm për shkak të kalimit të afatit të caktuar ligjor, afat ky i cili është i ndryshueshëm dhe varet nga lloji i veprës penale, si dhe lartësia e dënimit.

Parashkrimi i lëndëve në proceset penale paraqet një problematikë dhe sfidë për sistemin gjyqësor dhe prokurorial, marr për bazë numrin e lëndëve të parashkruara. Andaj, vëmendje iu kushtua faktorëve kryesor që ndikojnë në rritjen e lëndëve të parashkruara (konsiderohet ngarkesa e madhe me lëndë e gjyqtarëve dhe prokurorëve), por edhe faktorë tjerë që kanë të bëjnë me aspektin profesional të zbatimit të dispozitave ligjore që kanë si pasojë mosrespektimin e afateve ligjore.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor



Procedura në KPMShCK dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Më 17 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Ky trajnim kishte për qëllim avancimin e njohuritë të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e drejtë të legjislacionit mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë lëmi, zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur në procedurë gjyqësore si dhe evitimin e dilemave që kanë gjyqtarët lidhur me dispozitat ligjore përkatëse.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtua korniza ligjore për nëpunësit civil, procedurat dhe afatet në kuadër të organit të punësimit, procedura ligjore në KPMK, vendimet dhe mjetet juridike kundër vendimeve të Këshillit, zbatimi i vendimeve të KPMK-së dhe procedura

në rastet e mos zbatimit të vendimeve të KPMK-së.

Po ashtu u trajtuan procedurat gjyqësore në kontestet e marrëdhënies së punës për shërbyesit civil, sipas padisë për konfliktin administrativ duke përfshirë format, përmbajtjen dhe kushtet për ushtrimin e padisë, aktgjykimin në konfliktin administrativ si dhe mjetet juridike në konfliktin administrativ.

Me dobi ishin edhe analiza e vendimeve dhe interpretimet në këtë temë që kanë dhënë gjykatat e rregullta, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese përmes sqarimeve të trajnuesve.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm, divizionit civil, të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes

Më 22 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes”.

Ky trajnim kishte për qëllim që gjyqtarët të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen, nocionin e saj, përgjegjësinë deri tek kompensimi si dhe afatet dhe mbrojtjen gjyqësore.

Në pjesën e parë u trajtua nocioni i shpifjes dhe fyerjes, masat për mbrojtje nga shpifja dhe fyerja, përgjegjësia për shpifje dhe fyerje, rastet e përjashtimit nga përgjegjësia dhe kufijtë e përgjegjësisë si dhe praktika ndërkombëtare e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Në pjesën e dytë, u trajtua tematika lidhur me detyrimin për të zbutur dëmin dhe e drejta në reagim, kompensimi për shpifjen dhe fyerjen dhe afatet, mbrojtja e burimeve dhe gjykata kompetente.

Me dobi ishte edhe analiza e vendimeve dhe interpretimet në këtë temë që kanë dhënë gjykatat e rregullta të shteteve të rajonit dhe GJEDNJ, përmes sqarimeve të trajnuesve lidhur me shpifjen dhe fyerjen e ndërlidhur kjo me lirinë e shprehjes.

Ky trajnim iu dedikua gjyqtarëve të niveleve të ndryshme, duke pasur në fokus praktikën e mangët gjyqësore në çështjet e kompensimit të shkaktuar nga shpifja apo fyerja. Pjesëmarrësit patën mundësinë e marrjes së udhëzimeve të qarta për mënyrën e qasjes në praktikë të gjykimit të këtyre rasteve të cilat janë të ndjeshme në shoqërinë tonë për shkak të mentalitetit dhe mungesës së vetëdijes për lirinë e shprehjes që nuk do të thotë të flasësh, apo shkruash çka të duash, por atë që ke të drejtë.

Përfitues ishin gjyqtarët e divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme në gjykatat themelore dhe të Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale

Më 24 mars 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin, rëndësinë dhe vlerën provuese që kanë provat për vërtetimin e drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike në procedurën penale.

Ky trajnim trajtoj cilësimin dhe vlerësimin e provave në procedurë penale që si rezultat i të provuarit nga ana e palëve do të nxirret edhe çështja e bindjes së gjyqtarit për pranimin, respektivisht besueshmërinë e një prove e cila argumenton ose jo një fakt të rëndësishëm

juridik për vërtetimin ose gjetjen e përgjegjësisë penale të pandehurve.

Sipas Kodit të Procedurës Penale gjyqtarit i mbetet të vlerësoj në tërësi cilësinë e provës, duke fituar bindjen se sa është e besueshme ajo provë, çfarë rëndësie dhe vlere provuese ka ajo provë për vërtetimin e drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike në procedurë penale.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Shoqëritë Tregtare

Më 29 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Shoqëritë Tregtare”.

Qëllimi i trajnimit ishte t’iu mundësoj pjesëmarrësve të thellojnë njohuritë rreth plotësimit të kushteve ligjore që duhet të plotësohen lidhur me regjistrimin, themelimin dhe shuarjen e Shoqërive Tregtare, cilat janë të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë, si dhe llojet e Shoqërive Tregtare, kapaciteti dhe struktura e tyre juridike.

Me rastin e zbrërthimit të dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, janë dhënë sqarime për fushë veprimtarinë e tij, elementet dhe përkufizimet që i përmban ky ligj si përparësi por, njëkohësisht edhe çështjet të cilat nuk i rregullon ky ligj, çështjet kontestuese dhe procedura që zhvillohet pranë gjykatës lidhur me zgjidhjen e këtyre rasteve.

Në vazhdim në këtë trajnim u elaboruan edhe problemet me praktikë të kaluara afariste, përvojat dhe praktikët më të mira të shteteve në rajon dhe si të aplikohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë, roli dhe detyrat e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, si dhe shumë çështje tjera me rëndësi të cilat ndihmojnë në heqjen e dilemave dhe vështirësive që hasin gjyqtarët në praktikë.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive, ku përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve, u trajtuan dilemat rreth temave në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelorë nga Departamenti për Çështje Ekonomike, Departamenti për Çështje Administrative, Departamenti i Përgjithshëm si dhe zyrtarë ligjor të CLE/USAID.



Zbatimi i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

Me 31 mars 2017, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e UNDP-së në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “Rëndësia e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rëndësinë e zbatimit gjyqësor të KEDNJ dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) si dhe efekti i tyre në sistemin juridik-kushtetues të Republikës së Kosovës.

Në këtë trajnim gjithanshëm u trajtuan aspekte të zbatimit gjyqësor të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndikimi i vendimeve të GJEDNJ-së në jurisprudencën vendore, dhe portali HUDOC. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe interpretimit të dispozitave të Konventës duke u shërbyer me rastet nga

praktika e pasur e GJEDNJ dhe mënyrat e zbatimit në praktikë të dispozitave dhe vendimeve të saj nga shtetet palë të kësaj Konvente.

Gjithashtu në këtë trajnim u trajtuan edhe raste nga praktika e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të cilat kanë pasur efekt në gjyqësorin e rregullt.

Përmes diskutimeve dhe shembujve studimor u zbërthyen të drejtat e përcaktuara me KEDNJ dhe vendimet e rëndësishme të jurisprudencës së GJEDNJ të cilat janë me vlerë obligative për gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Kosovës si shtet i rrethit juridik evropian.

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor pjesëmarrës të këtij trajnimi, kanë thelluar dijet e tyre në zbatimin e dispozitave të KEDNJ, përmes sqarimeve dhe përgjigjeve të trajnuesve.



Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit - Sesioni I

Më datë 31 mars dhe 1 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, realizoi trajnimin “Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit - Sesioni I”.

Trajnimi kishte për synim avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me korrupsionin, pasojat e korrupsionit, format e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veprat penale korruptive dhe elementet e tyre.

Në sesionin e parë u elaborua kuptimi i korrupsionit sipas legjislacionit në fuqi, legjislacioni ndërkombëtar i aplikueshëm në këtë fushë, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, keqpërdorimi i informatës zyrtare, konflikti i interesit, përvetësimi në detyrë, mashtrimi në detyrë, marrja dhe dhënia e ryshfetit dhe ushtrimi i ndikimit.

Gjithashtu u trajtuan planet hetuese dhe hapat e parë të hetimit, zhvillimi i një plani hetues,

trajtimi dhe analizimi i informatave publike të disponueshme dhe qasja në dokumente dhe informata jo publike, si dhe marrja dhe kërkimi i evidencave elektronike.

Në sesionin e dytë u elaborua mënyra e përgatitjes së materialeve lidhur me masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit për zbulimin e korrupsionit, llojet, kushtet, personat kompetent për të lëshuar këto masa, përmbajtja dhe kohëzgjatja e urdhrave për lëshim të masave, ndihma e organeve tjera për zbatimin e këtyre masave, mënyra e dorëzimit të shkresave si dhe raportet tek palët lidhur me këto masa në procedurë.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive dhe me një rast ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre.

Përfitues të këtij trajnim ishin gjyqtarë, prokurorë si dhe bashkëpunëtorë profesional të niveleve të ndryshme.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF– Mars 2017

Gjatë muajit mars 2017, janë realizuar aktivitete trajnuese në përmbushje të Programit të Trajnimit Fillestar, për prokurorët e shtetit të sapoemëruar.


Në kuadër të trajnimit teorik, kanë vazhduar dhe janë realizuar edhe 2 sesione trajnuese nga nën-moduli “KEDNJ-legjislacioni për të drejtat e njeriut”, ku janë trajtuar neni 13 dhe 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në përmbushje të trajnimit teorik, janë realizuar edhe 6 sesione trajnuese nga nën-moduli “Kallëzimi penal”. Në kuadër të këtij nën-moduli janë shtjelluar çështjet mbi kallëzimin penal në përgjithësi, kuptimi i kallëzimit penal, kallëzimi penal i policisë, kallëzimi penal nga burimet tjera, kallëzimi penal i cili i paraqitet Prokurorit të Shtetit, të dhënat plotësuese të kallëzimit penal dhe hedhja e kallëzimit penal. Po ashtu, janë realizuar edhe 8 sesione trajnuese nga nën-moduli “Aktakuza-procedura e shqyrtimit”, në kuadër të cili janë elaboruar aktakuza dhe elementet e domosdoshme të saj, ngritja e aktakuzës, të drejtat e të pandehurit pas pranimit të aktakuzës, ndryshimi, zgjerimi dhe

hedhja e aktakuzës, përfaqësimi i saj nga Prokurori i Shtetit në fazat e shqyrtimit gjyqësor, propozimet ndaj kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore, si dhe propozimet ndaj të miturve si kryerës të veprave penale.

Në kuadër të programit, u realizua edhe aktiviteti “Zhvillimi i komponentës hulumtuese dhe mësimi në distancë”, ku prokurorët e sapoemëruar janë regjistruar në platformë, janë njoftuar për mënyrën e ndjekjes së trajnimeve nga distanca, me procedurën e hartimit të punimeve për revistën “Justicia”, si dhe me mundësinë e shfrytëzimit të burimeve ligjore në bibliotekën e Akademisë së Drejtësisë.

Në kuadër të trajnimit praktik në prokurori, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre. Po ashtu, në drejtim të përmbushjes së programit trajnues, prokurorët e sapo emëruar kanë vijuar trajnime në këto institucione: Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Komisionin e Ndërmjetësimit dhe Doganën e Kosovës.



Trajnimi praktikë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Më 15 mars 2017, në kuadër të trajnimeve praktike në institucionet jo gjyqësore, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka realizuar trajnimin për prokurorët e sapoemëruar.



Qëllimi këtij trajnimi ishte që prokurorët e sapoemëruar të thellojnë njohuritë e tyre lidhur me rolin, përgjegjësitë dhe punën praktike të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Fillimisht në kuadër të këtij trajnimi u shtjellua misioni dhe baza ligjore me të cilën funksionon Agjencia Kadastrale, struktura organizative, të arriturat dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion në përmbushjen e detyrimeve të saj.

Më tej trajnimi vazhdoj me trajtimin e bazës ligjore dhe disa rasteve praktike nga lëmia e regjistrimit të së drejtës së pronës së pa luajtshme, të cilat u diskutuan së bashku me ekspertët e kësaj fushe nga AKK.

Prokurorët e sapoemëruar, kishin rastin të njoftohen me punën praktike të cilën e zhvillon AKK, duke vizituar në këtë formë për së afërmi ambientet dhe zyrtarët e AKK-së, të cilët ofruan sqarime konform detyrave dhe njësive përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e shtetit të sapoemëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnimi praktik në Komisionin e Ndërmjetësimit

Më 22 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për prokurorët e shtetit të sapoemëruar, ka realizuar trajnimin praktik për Komisionin e Ndërmjetësimit.

Qëllimi i trajnimit ishte që prokurorët e sapoemëruar të thellojnë njohuritë për rolin dhe funksionet e Komisionit për Ndërmjetësim si dhe sistemit të ndërmjetësimit në përgjithësi.

Në kuadër të këtij trajnimi u pasqyrua një historik i shkurtër i zhvillimit të ndërmjetësimit në Kosovë, si dhe kompetencat e Komisionit për Ndërmjetësim.

Gjithashtu, në mënyrë të hollësishme u trajtua korniza ligjore për ndërmjetësim, e cila është e

zbatueshme në Kosovë, struktura e sistemit të ndërmjetësimit dhe mënyra e referimit të rasteve për ndërmjetësim nga ana e prokurorëve. Trajnimi vazhdoi me trajtimin e procesit të ndërmjetësimit, duke përfshirë fillimin, zhvillimin dhe arritjen, apo jo, të marrëveshjes në këtë proces.

Në këtë kuadër u diskutuan çështjet me interes të përbashkët, me ç' rast prokurorët e sapoemëruar, u njoftuan me përparësitë që ofron sistemi i ndërmjetësimit në përgjithësi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të shtetit, gjenerata e VI e PTF-së



Trajnimi praktik në Doganën e Kosovës

Më 29 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, ka realizuar trajnimin për prokurorët e shtetit të sapoemëruar.

Trajnimi kishte për qëllim që prokurorët e sapoemëruar të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me fushë veprimtarinë e Doganës së Kosovës në përgjithësi, punën praktike si dhe fushat e interesit të përbashkët në veçanti.

Në kuadër të këtij trajnimi, shkurtimisht u shtjellua historiku dhe procesi i zhvillimit të Doganës, roli dhe misioni i saj, legjislacioni mbi të cilin ushtron kompetencat e saj si dhe bashkëpunimi me institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Me tej, trajnimi vazhdoi me diskutimin e çështjeve praktike në sistemin e të drejtës penale në fushën e doganave, krahasimin e neneve përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit Doganor që rregullojnë këtë materie, ku u paraqiten sfidat aktuale që has Dogana e Kosovës në këtë fushë.

Në këtë kuadër, prokurorët e sapoemëruar dhe zyrtarët e Doganës e pajtuan që në të ardhmen bashkëpunimi duhet të vazhdoj dhe të avancohet mes tyre, me qëllim luftimin e suksesshëm të dukurive negative të kësaj natyre

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të shtetit, gjenerata e VI-të e Programit për Trajnim Fillestar.



Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)

Punëtorja për zhvillimin e botimeve ligjore

Me datën 14.03.2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ-it ka realizuar punëtorinë me temë "Zhvillimi i botimeve ligjore".

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte fuqizimi dhe zhvillimi i veprimtarisë botuese të Akademisë së Drejtësisë me qëllim të dokumentimit të zhvillimeve aktuale ligjore, nxitjen e zhvillimit të ligjit dhe për informimin e praktikuesve të ligjit.

Me rastin e kësaj punëtorie u trajtuan çështjet rreth funksionit të publikimeve ligjore, procesit të botimeve, grupit të synuar si dhe çështjet rreth përmbajtjes, përzgjedhjes dhe redaktimit nga perspektiva gjermane.

Gjatë punëtorisë nga grupi i pjesëmarrësve u vu në pah mungesa e publikimeve vendore në fushën ligjore veçanërisht e publikimit të vendimeve gjyqësore. Kjo problematikë siç u tha mbetet për tu adresuar duke pasur parasysh interesin e profesionistëve ligjor për të pasur më shumë burime juridike dhe publikime në këtë fushë.

Pjesëmarrës në punëtori ishin trajnuesit e Akademisë e që njëkohësisht janë edhe autorë të punimeve në revistat e IGJK-së tashmë të Akademisë.



Aktivitetet Tjera

Program intershipi i kandidatëve nga Shkolla Kombëtare e Magjistraturës së Francës -ENM

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë (ish IGJK) dhe Shkolla Kombëtare e Magjistraturës së Francës – ENM, prej dt. 20 shkurt deri me 10 mars dy kandidatë të kësaj shkolle kanë qëndruar në Kosovë në një program praktik të trajnimit.



Objektivat e këtij programi qëndrojnë në njoftimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të Francës, me sistemin gjyqësor në Kosovë, veçanërisht në ndjekjen, hetimin dhe gjykimin e veprave penale, si dhe zbatimin e dënimeve, çështjet gjyqësore familjare, kontrata dhe përgjegjësitë, të kuptuarit e dimensionit ndërkombëtar të drejtësisë dhe të kuptuarit e sistemeve të huaja të trajnimit të gjyqtarëve.

Akademia ka pasur rolin kryesor në përgatitjen e këtij programi internshipi e cila përmban trajnimin praktik që realizohet në gjykata dhe prokurori në mbështetje të gjyqtarëve/prokurorëve në cilësinë e mentorit si dhe janë organizuar takime me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë.

Agjenda ka filluar me një takim në Akademinë e Drejtësisë, ku janë njoftuar në përgjithësi lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës,

funksionet, përgjegjësitë si dhe programet që i zhvillon Akademia. Po ashtu kandidatët kanë pasur rastin të ndjekin një trajnim nga KEDNJ i cili u realizua në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapoemëruar.

Në kuadër të agjendës së programit, kandidatët nga ENM kanë vazhduar trajnimin në Prokurorinë Themelore dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mbështetje të një prokurori dhe dy gjyqtarëve njëri në çështje penale dhe tjetri në ato civile. Kandidatët kanë pasur mundësi që të ndjekin seanca të ndryshme lidhur me procedurën e hetimit, me njoftimin më të gjerë për sistemin gjyqësor, gjykimin e veprave penale e veçanërisht veprave penale të korrupsionit dhe zbatimin e dënimeve në Kosovë.

Po ashtu, gjatë këtij programi kandidatët kanë pasur rast të ndjekin seanca të ndryshme lidhur me kontestet familjare, dhunë në familje, rolin e palëve ndërgjyqësve, dëgjimin e dëshmitarëve, çështje lidhur me kontratat dhe aspekte tjera materiale dhe procedurale në fushën civile. Theks të veçantë i është kushtuar të kuptuarit e procedurave, krahasimit të sistemeve gjyqësore të dy vendeve, si dhe shkëmbimit të përvojave në fushën gjyqësore.



Trajnimi për Trajnues

Neni 10 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

Me 01 - 04 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore (JUFREX)”, realizoj trajnimin për trajnues “Neni 10 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me prezantimin e doracakut mbi nenin 10 të KEDNJ, liria e shprehjes dhe mediat, roli i gjyqtarëve dhe prokurorëve në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të medias, si dhe efekti i saj në sistemin juridik të GJEDNJ dhe Kosovës.

Në fokus të trajnimit ishte analizimi i dispozitave të nenit 10 të KEDNJ. Më konkretisht u elaborua natyra, rëndësia, efekti dhe fushëveprimi i të drejtës në lirinë e shprehjes, nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shpifja, figurat publike në media,

përgjegjësitë dhe sanksionet në gazetari, ndërhyrjet në lirinë e internetit dhe mbrojtja e aktivitetit të gazetarisë dhe medias në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe në praktikën e GJEDNJ.

Gjatë trajnimit, trajnuesit patën rastin të ndahen në grupe për t’i zgjidhur rastet që ishin dedikuar shpifjes, përgjegjësitë dhe sanksionet në gazetari, mbrojtja e aktivitetit gazetarisë dhe medias.

Gjithashtu trajnuesit gjatë punës në grupe kanë bërë simulim të seancës gjyqësore për zgjidhjen e rasteve në bazë të legjislacionit vendor duke i krahasuar me rastet dhe vendimet e rëndësishme të jurisprudencës së GJEDNJ, e që janë me vlerë obligative për gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Kosovës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë dhe avokatë nga OAK.



Menaxhimi i Gjykatave/Prokurorive - Sfidat Praktike dhe Zhvillimi i Kurrikulës

Me 10 mars 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit "Mbështetje e mëtutjeshme e reformës për arsimim ligjor" realizoi trajnimin me temë "Menaxhimi i Gjykatave dhe Prokurorive - Sfidat Praktike dhe Zhvillimi i Kurrikulës".

Ky trajnim ka ofruar mundësinë kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve të prokurorive të diskutojnë çështjet e menaxhimit të gjykatave dhe prokurorive nga pikëpamja e praktikuesve të ligjit.

Në trajnim u diskutua rreth përcaktimit të temave kryesore për modulet e trajnimit në të ardhmen, rreth menaxhimit të gjykatave dhe prokurorive në aspektin e praktikave që ndërliken me programin e trajnimit fillestar.

Kjo punëtori i dha Kryetarëve dhe Kryeprokurorëve të sapoemëruar dhe atyre të ri-emëruar një mundësi për diskutimin e çështjeve relevante për menaxhimin e

gjykatave dhe prokurorive nga këndvështrimi i ushtruesve të profesionit. Trajnimi është mbështetur gjithashtu nga programi CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitet në Drejtësi) në Kosovë, i cili ka ofruar udhëzimet e tij dhe mjetet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit janë ndarë në dy grupe, me ç' rast njëri grup kanë punuar në detyrën rreth menaxhimit të një gjykate dhe prokurorie dhe grupi tjetër në zhvillimin e një kurrikule në menaxhim të gjykatave dhe prokurorive.

Përfitues të trajnimit ishin kryetari i Gjykatës së Apelit, kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Kryetarët e gjykatave themelore dhe Kryeprokurorët e prokurorive themelore.



Forumi i Katërt Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore

Më datë 17 dhe 18 mars 2017, përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë kanë marrë pjesë në “Forum in e Katërt Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore” të organizuar nga AIRE Centre dhe Civil Rights Defenders, me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Qeverisë së Suedisë, Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit dhe të GIZ-it.

Qëllimi i Forumit ishte promovimi i zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rajon, inkurajimi i bashkëpunimit në zhvillimin e vazhdueshëm të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, si edhe asistimi në procesin e integritetit të rajonit në BE.

Në këtë forum u theksua se “Ideja krijimit të Forumit të Sundimit Rajonal të Ligjit ka lindur nga të kuptuarit se duke inkurajuar dhe lehtësuar bashkëpunimin dhe dialogun rajonal, mund të ndahen praktikat dhe mësimet më të mira diçka që është edhe e nevojshme dhe e dëshirueshme, me qëllim që të tejkalohen

sfidat e përbashkëta me të cilat përballet rajoni”.

Forum i këtij viti u fokusua në të drejtën e lirisë së shprehjes në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe në veçanti marrëdhëniet e saj me të drejtën për respektimin e jetës private dhe të drejtën për gjykim të drejtë.

Punimet e këtij forumi i kanë ndjekur më shumë se 160 përfaqësues të shquar të gjykatave më të larta, Gjykata e Lartë dhe Kushtetuese, Këshillat gjyqësorë, drejtorët e akademive gjyqësore, institucioneve dhe organizatave jo-qeveritare në Shqipëri, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina (BiH) dhe Serbisë, si dhe përfaqësues të këtyre vendeve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.



Punëtori për zhvillimin e kapaciteteve të stafit të sistemit prokurorial të Kosovës

Me 24 - 25 mars 2017, Akademia e Drejtësisë organizoi punëtorinë me temë “Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës”.

Qëllimi i realizimit të kësaj punëtorie ishte që pjesëmarrësit të avancojnë njohuritë rreth zhvillimit të resurseve për komunikim me publikun, hartimit të akteve të ndryshme ligjore dhe sigurimit të qasjes dhe standardeve të unifikuara për hartimin e të gjitha llojeve të akteve si dhe identifikimi i nevojave për përfitim të projekteve nga fondet e IPA-së 2018-2020.

Gjatë kësaj punëtorie, u trajtuan tema të rëndësishme për funksionimin e sistemit prokurorial të Kosovës si: roli i Sekretariatit të

KPK-së në efikasitetin e sistemit prokurorial, planifikimi i detyrave të punës për vitin 2017 në frymën e planeve të KPK-së, Rregullores së SKPK-së dhe detyrave të punës, transparenca, dizajni dhe përmbajtja e faqes zyrtare të KPK-së si dhe platformave tjera të mundshme.

Përfitues të punëtorisë ishin udhëheqësit e njësive organizative të Sekretariatit dhe Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, zyrtarët ligjor të KPK-së dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe zyrtarë tjerë.

Trajnimi u realizua nga Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Trajtimi Gjyqësor i Terrorizmit

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës (ENM) prej datës 26-30 mars 2017 një prokurorë i Prokurorisë Speciale të Kosovës ka qëndruar në Francë në një program trajnimi me temë “Trajtimi Gjyqësor i Terrorizmit”.

Në përmbajtje, ky aktivitet trajnues përfshinte tema si: Policia kundër terrorizmit dhe mekanizmat e inteligjencës, niveli i kërcënimit nga terrorizmi, mjetet gjyqësore kundër terrorizmit dhe menaxhimi operacional, shpjegimet lidhur me ideologjitë xhihadiste, hetimi i terrorizmit, negocimi në aksionet kundër terrorizmit, roli i informatave inteligjente në procedurat gjyqësore, vendi i ngjarjes tek rastet e terrorizmit, minat dhe mjetet tjera shpërthyesë të improvizuara, vendimet gjyqësore dhe sfidat tek rastet e terrorizmit, radikalizmi nëpër burgje si dhe sigurimi i bizneseve e aseteve nga rreziku i terrorizmit.

Fokusi i këtij programi trajnues ishte i drejtuar në aspektin praktik dhe sfidat e drejtpërdrejta të autoriteteve franceze në parandalimin, luftimin e terrorizmit si dhe rehabilitimin e të dënuarve për vepra të ndryshme të cilat ndërlidheshin me terrorizmin. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe rolit të gruas në idoktrinim, radikalizëm, përkrahje materiale e ndihmë konkrete në kryerjen e veprave penale të cilat ndërlidhen me terrorizmin, e gjithashtu edhe përfshirjes së fëmijëve drejtpërsëdrejti në kryerjen e veprave të ndryshme të terrorizmit. Ky fenomen ishte shqetësues për autoritetet franceze meqë ishte në rritje gjithnjë e më shumë.

Pjesëmarrës të këtij aktiviteti trajnues ishin gjyqtar dhe prokuror të vendeve të ndryshme nga Afrika dhe Evropa të cilët po ballafaqohen me sfida të reja në fushën e terrorizmit, e po ashtu kishte pjesëmarrës edhe nga Amerika Latine. Ky program praktik është financuar nga Ambasada e Francës në Prishtinë.



Punëtori “Dialogu institucional në mes të KGJK-së, KPK-së, dhe ADK-së për çështje të interesit të përbashkët”

Nga data 29-31 mars 2017, Akademia e Drejtësisë, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kanë mbajtur një punëtori të përbashkët të organizuar me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë - UNDP.

Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ishte bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të sistemit gjyqësor në Kosovë duke ndarë përvojat e adresimit dhe menaxhimit të proceseve kryesore nëpër të cilat janë duke kaluar, si dhe për trajnimet në ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive, për të kryer me sukses dhe efikasitet punën e tyre.

Në këtë punëtori si temë e rëndësishme e diskutimit ishte edhe zbatimi i Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, ndryshimet që ka sjell ky ligj, funksionet dhe kompetencat e

Akademisë së Drejtësisë.

Ndër temat e tjera në diskutim ishin: Vlerësimi i performancës së prokurorëve, procedurat disiplinore, transferimi, rekrutimi, emërimi i ekspertëve dhe kompensimi, administrimi i gjykatave dhe prokurorive, si dhe koordinimi institucional në lidhje me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve etj.

Në fund të kësaj punëtorie dy ditore të zhvilluar në Tiranë, përfaqësuesit dhe ekspertët e të tri institucioneve gjyqësore të shtetit, erdhën në një përfundim të përbashkët për bashkëpunim edhe më intensiv për realizimin e mandatit të përcaktuar me ligj.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**